



## **KËSHILLI BASHKIAK**

### **V E N D I M**

Nr.12, datë 11.03.2016

**Për**

#### **“MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE KULTURORE, ARTISTIKE, RINORE DHE SPORTIVE”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 15, pika 2; neni 25, pikat 2 dhe 4; nenit 55, pikat 2 dhe 6; nenit 64, shkronja “j” të Ligjit nr.139/2015 datë. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenet 124 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr.7776, datë 23.12.1993 “Për buxhetin lokal”(i ndryshuar); Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 për “Tatimin mbi të ardhurat”(i ndryshuar); Ligjit nr.10352, datë 18.11.2010 për “Artin dhe Kulturën”(i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr 150, datë 3.04.1993, “Për financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive” (i ndryshuar); Udhëzimit të përbashkët Nr. 5, datë 18.05.2000 të Ministrisë së Kulturës Rinisë e Sporteve Nr. 2094 Prot, datë 29.09.1993 dhe Ministrisë e Financave Nr. 5134/1 Prot, dt. 17.12.1993; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr 2, datë 11. 2. 2002 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”: nenit 31, të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.31 datë 31.05.2004 “Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Tiranë” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.10, datë 30.04.2014 mbi “Krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.35, datë 15.03.2001 “Rregullore mbi financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive”; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 58, datë 30.12.2015 për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së Tiranës për vitin 2016” ; Rregullores për financimin e shpenzimeve operative dhe kapitale të aparatit të Bashkisë së Tiranës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak:

#### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike dhe sportive.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
3. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 35, datë 15.03.2001 “Rregullore mbi financimin e projekteve kulturore, artistike dhe sportive” shfuqizohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetw) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R**

ALDRIN DALIPI